



UNIVERSITETI I SHKODRËS “LUIGJ GURAKUQI”

**UDHËZUES MBI MËSIMDHËNIEN E STUDENTËVE ME
AFTËSI TË KUFIZUARA**

***STRATEGJI TË MËSIMDHËNIES QË DO TË
NDIHMojnë NË FUQIZIMIN E STUDENTËVE TUAJ ME
AFTËSI TË KUFIZUARA***



Erasmus+

PARATHËNIE

Ky udhëzues vjen si produkt i projektit *IDEA “Inclusive tertiary Education in the West BalkanS”* realizuar në universitetit tonë për tre vite (2020-2023).

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të njohë stafin akademik të fakulteteve të universitetit me disa teknika të mësimdhënies me studentë me aftësi të kufizuara, të cilët do t’i ndihmojnë ata në ofrimin e qasjes dhe udhëzimit të barabartë për të gjithë, për të lehtësuar aksesueshmerinë e tyre në procesin e mësimdhënies dhe të nxënies.

Stafi akademik përmes këtij udhëzuesi mund të mbështesë dhe ndihmojë studentët me aftësi të kufizuara që të fuqizojë integrimin sa më të lehtë në veprimtaritë mësimore në auditor dhe jashtë tij.

KONCEPTI ‘AFTËSI E KUFIZUAR’

Sipas OBSH-së, Aftësia e Kufizuar ka tre dimensione:

- **Dëmtimi** në funksionimin, në strukturën e trupit, apo në funksionimin intelektual. Shembuj të dëmtimeve përfshijnë: humbjen e një gjymtyre, humbje të shikimit ose humbje të kujtesës.
- **Kufizimet në veprimtari**, të tilla si vështirësi në shikim, dëgjim, ecje ose problemzgjdhje.
- **Kufizimet në pjesëmarrje** në aktivitetet normale të përditshme, të tilla si puna, përfshirja në aktivitete sociale dhe rekreative dhe marrja e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve parandaluese (cituat nga CDC, 2020).

Aftësia e kufizuar u referohet vështirësive të hasura në njërin prej këtyre fushave të funksionimit apo në të gjitha ato (WHO, 2011, f.5).

Në KDPAK, (Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara) personat me aftësi të kufizuar përkufizohen, si: *“individë që kanë për një kohë të gjatë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore, të cilat në ndërveprim me barrierat e ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, në baza të barabarta me të tjerët”* (cituat nga World Vision, 2012, f.12).

Sipas Strategjisë sonë Kombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, *“Personat me Aftësi të Kufizuara janë ata persona të cilët funksionet fizike, kapaciteti mendor ose gjendja psikologjike kanë prirje të shmangen për më shumë se gjashtë*

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

muaj nga gjendja tipike për moshën përkatëse, gjë që sjell për pasojë kufizime të pjesëmarjes së tyre në jetën shoqërore”. Tek “Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara” jepet edhe klasifikimi i Aftësisë së Kufizuar.

Sipas llojit të aftësisë së kufizuar PAK-të (Personat me Aftësi të Kufizuara) grupohen në:

- **sensorë**, ku hyjnë personat me aftësi të kufizuara dëgjimore dhe pamore;
- **fizikë**, ku hyjnë njerëzit me aftësi të kufizuara lëvizore, si: para e tetraplegjikët, etj.;
- **mendorë**, ku hyjnë persona me çrregullime mendore ose sëmundje mendore kronike (Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar, 2005, f.6).

Personat me aftësi të kufizuara përballen me shumë barriera çdo ditë, nga pengesat fizike në ndërtesa deri tek pengesat sistemike në punësim dhe programet qytetare. Megjithatë, shpesh, pengesat më të vështira për t’u kapërcyer janë qëndrimet që njerëzit kanë ndaj njerëzve me aftësi të kufizuara (NCWD/YOUTH, 2020). Një barrierë është çdo gjë që pengon aksesin e barabartë në të mirat, shërbimet apo në informimin e një personi apo të një grupi njerëzish (Sahu K.K., Sahu S., 2015, f.2).

Organizata Botërore e Shëndetit (OBSh) i përshkruan barrierat si më shumë se sa pengesa fizike. Përkufizimi i barrierave sipas OBSh-së: “Faktorët në mjedisin e një personi që, përmes mungesës ose pranisë së tyre, kufizojnë funksionimin dhe krijojnë aftësi të kufizuar. Këto përfshijnë aspekte të tilla, si:

- një mjedis fizik që nuk është i arritshëm (i aksesueshëm),
- mungesa e teknologjisë përkatëse ndihmëse (pajisje ndihmëse, adaptuese dhe rehabilituese),
- qëndrime negative të njerëzve ndaj aftësisë së kufizuar,

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

- shërbime, sisteme dhe politika që janë ose inekzistente, ose që pengojnë përfshirjen e të gjithë personave me një rrethanë shëndetësore në të gjitha fushat e jetës”(WHO, 2001) (cituar nga CDC, 2019).

Sipas Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026 ” Vizioni për sektorin e arsimit synon ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt për diversitetin. Gjithëpërfshirja dhe barazia janë parakushte të domosdoshme për të siguruar formimin cilësor të të gjithë individëve dhe për të ngushtuar hendekun e arritjeve arsimore midis grupeve të ndryshme sociale (f.67)”.

1. PËR MËSIMDHËNIEN E STUDENTËVE TË VERBËR OSE ME SHIKIM TË DËMTUAR

Çrregullimet e shikimit

Dëmtimi i shikimit (VI) është një kufizim funksional i syve dhe/ose i sistemit vizual i lidhur me humbjen e mprehtësisë pamore (VA) dhe/ose humbjen e fushës pamore (VF) (WHO, 2001) (cituar nga [Lupón M. et al., 2021](#)).

STRATEGJI EFEKTIVE TË MENAXHIMIT TË KLASËS DHE MËSIMDHËNIES

- **Përdorni gjithmonë verbalizimin dhe emra**

Përdorni përshkrime verbale për të kompensuar mungesën e mprehtësisë vizuale ose qartësinë vizuale. Përdorni gjithmonë në fillim emrin e studentit me shikim të dëmtuar kur i drejtoheni. Në këtë mënyrë ai/ajo do të kuptojë se ju po flisni me të dhe jo me dikë tjetër. Kur i kaloni nëpër korridore, në vend që të thoni “Përshtëndetje”, thërrasin emrat e tyre, pasi studentët e verbër ose me shikim të dëmtuar mund të mos jenë në gjendje të njohin fytyrat. Për shembull: “Përshtëndetje Sara, jam prof. X! Si jeni sot?” Nxitini studentët tuaj të bëjnë të njëjtën gjë, sepse kjo nxit lidhjen në komunitetin e studentëve.

- **Është në rregull të përdoren fjalë që i referohen shikimit**

Mos shmangni fjalët si “shiko” dhe “shikoni”. Ashtu si bashkëmoshatarët e tyre me shikim normal, këto fjalë duhet të jenë pjesë e fjalorit të një studenti të verbër ose me shikim të

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

dëmtuar për të nënkuptuar mënyrën se si ata shohin, qoftë edhe me prekje.

- **Mos bëni gjeste, gjithmonë verbalizoni**

Kur shkruani në tabelë, gjithmonë verbalizoni atë që po shkruani në mënyrë që studentit të ketë akses në atë informacion dhe të mund ta ndjekë. Përdorni koncepte pozicioni dhe drejtimi, si: sipër/poshtë, mbi, prapa/përpara, majtas/djathtas, etj., dhe përdorni fjali përshkuese si “Topi është afër derës” në vend të “Topi është atje”. Shmangni fjalët dhe frazat, si: “këtu”, “atje” dhe gjestet që japin drejtim, p.sh. duke treguar një vend pa folur me fjalën për atë që tregohet, sepse studentët me dëmtim të shikimit nuk mund ta shohin atë.

- **Shmangni pyetjen nëse një student mund të shohë diçka**

Mos pyesni një student: “A mund ta shihni këtë?” Ata shpesh mund ta shohin atë, por kjo nuk do të thotë se ata mund ta përdorin atë ose ta lexojnë atë. Në vend të kësaj pyesni, “A mund ta gjeni X?” ose “A mund t’i identifikoni të gjitha fjalët dhe numrat pa i marrë me mend?” ose “A mund t’i shihni disa pjesë të tabelës më mirë se të tjerat?”

- **Pozicioni i duhur është vendimtar**

Verifikoni bashkë me studentët se ku dhe si mund të shohin më mirë në mënyrë që të mund të ulen në vendin optimal për sa i përket dritës, errësirës, lëvizjes dhe shikimit periferik. Gjithmonë favorizoni anën më të fortë të shikimit të studentit për shkak të mungesës së fushës vizive. Për shembull, nëse studentit përdor vetëm syrin e majtë, ai do të duhet të ulet në anën e djathtë të

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

klasës larg dritareve. Ulja përballë një burimi drite (dielli, dritaret) në mënyrë ideale duhet të jetë prapa tyre.

- **Përshtatni detyrat dhe procedurat e vlerësimit**

Përshtatni detyrat dhe procedurat e vlerësimit. Përdorni alternativa lidhur me detyrat e vlerësimit vizual, si p.sh. vlerësimet verbale.

- **Minimizoni zhurmat**

Përpiquni të minimizoni zhurmën dhe shqetësimet në klasë, pasi studenti me dëmtim të shikimit mbështetet në udhëzime dhe informacione verbale.

- **Kohë në favor**

Lejoni kohë shtesë dhe/ose ndani detyrat në copa më të vogla aty ku nevojitet.

- **Ofroni materiale lehtësisht të lëxueshme**

Siguroni një versioni të madh të printuar të tekstit. Një version i madh i shtypur i tekstit është material (p.sh. tekst shkollor ose roman) që është përgatitur në një madhësi më të madhe të shkronjave. Shkronja standarde e madhe është 18 ose 24 p.

- **Përdorni një lexues të drejtpërdrejtë.**

Një lexues i drejtpërdrejtë është një person, si p.sh. një bashkëmohatar, prindi ose një person mbështetës që i lexon një student. Ai/ajo mund të përdorë një lexues të drejtpërdrejtë, sepse ata ka vështirësi me leximin; nuk mund të ketë akses fizikisht në materialin e shtypur; ose nuk e ka materialin e shtypur në madhësinë e duhur.

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

- **Siguroni libra dëgjimorë në CD.**

Një libër audio CD është një regjistrim i përmbajtjes së një libri të lexuar me zë të lartë nga një zë njerëzor. Në varësi të riprodhuesit CD, mund të ketë veçori të përmirësuara të navigimit dhe kërkimit.

- **Siguroni libra në format audio digjital.**

Librat në format audio digjital mund të jenë ose regjistrime të zërave njerëzorë që lexojnë libra ose zëra kompjuteri. Librat në këtë format mund të interpretohen në një kompjuter ose në një riprodhues audio digjital (Special Education Technology British Columbia, 2010, f.23-25).

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

2. PËR MËSIMDHËNIEN E STUDENTËVE ME DËMTIME DËGJIMI

Çrregullimet e dëgjimit

Aftësia e kufizuar në humbjen e dëgjimit i referohet humbjes së dëgjimit më të madhe se 35 decibel (dB) në veshin me dëgjimin më të mirë (WHO, 2021).

Sipas OBSH-së, shkallët e dëmtimit të dëgjimit janë:

Shkallët e dëmtimit të dëgjimit

Shkalla e dëmtimit	Vlera përkatëse ISO audiometrike	Performanca	Rekomandime
0 -Jo dëmtim	25 dB ose më mirë (veshi më i mirë)	Jo probleme me dëgjimin ose shumë të lehta. Në gjendje për të dëgjuar pëshpëritje.	
1 -Dëmtim i lehtë	26-40 dB (veshi më i mirë)	Të aftë për të dëgjuar dhe përsëritur fjalët e folura në zë normal në 1 metër.	Këshillimi. Aparatet e dëgjimit mund të jenë të nevojshme.

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

2 -Dëmtim i moderuar	41-60 dB (veshi më i mirë)	Të aftë për të dëgjuar dhe përsëritur fjalët e folura me zë të ngritur në 1 metër.	Zakonisht rekomandohen aparate dëgjimi.
3 -Dëmtim i ashpër	61-80 dB (veshi më i mirë)	Në gjendje të dëgjonjë disa fjalët kur bërtasin në veshin më të mirë.	Nevojiten aparate dëgjimi. Nëse nuk ka aparate dëgjimi në dispozicion, leximi i buzëve dhe gjuha e shenjave duhet të mësohen.
4 -Dëmtim i thellë duke përfshirë shurdhim	81 dB ose më shumë (veshi më i mirë)	Në pamundësi për të dëgjuar dhe kuptuar edhe kur i bërtasin	Aparatet e dëgjimit mund të ndihmojnë për të kuptuar fjalët. Nevojitet rehabilitim shtesë. Leximi i buzëve dhe ndonjëherë gjuha e shenjave janë thelbësore

Shkallët 2, 3 dhe 4 klasifikohen si AK dëmtim dëgjimi. Vlerat audiometrike ISO janë mesataret e vlerave në 500, 1000, 2000, 4000 Hz. (WHO, 2021).

STRATEGJI EFEKTIVE TË MENAXHIMIT TË KLASËS DHE MËSIMDHËNIES

- **Sigurohuni që të ketë një vijë të qartë të shikimit.**

Ju mund t'i ndihmoni studentët tuaj me vështirësi në dëgjim duke i ftuar ata të ulen në pjesën e përparme të klasës nëse dëshirojnë. Nëse studenti juaj përdor një interpret ose mbështetet në leximin e buzëve, të dhëna vizuale ose një aparat dëgjimi, të qenit më afër, përpara do ta ndihmojë atë të mësojë. Sigurohuni që të jeni përballë klasës kur flisni, jo përballë dërrasës së bardhë. Ndriçimi i mirë është, gjithashtu, i domosdoshëm në mënyrë që ata t'ju shohin qartë. Flisni normalisht dhe qartë, duke theksuar fjalët kyçe. Përsëriteni dhe riformuloni kur është e nevojshme. Nëse po organizoni një aktivitet në grup, ndihmoni studentët që lexojnë buzët duke e pozicionuar grupin në një rreth, në mënyrë që studenti i shurdhër të mund t'i shohë të gjithë pjesëmarrësit e tjerë teksa flasin (Deaf Unity, 2020).

Për të bërë të mundur që personi që nuk dëgjon të lexojë mirë buzët tona:

- ✓ Nuk duhet të qëndrojmë më larg se një metër e gjysmë gjatë bisedës.
- ✓ Burimi i dritës duhet të ndriçojë fytyrën e atij që flet dhe jo të personit që nuk dëgjon.
- ✓ Ai që flet duhet ta mbajë kokën të palëvizur.
- ✓ Fytyra e atij që flet duhet të jetë në të njëjtin nivel me personin që nuk dëgjon.
- ✓ Duhet folur qartë, por pa e ekzagjeruar. Në asnjë mënyrë nuk duhet ndryshuar shqiptimi. Leximi i buzëve bazohet në

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

- shqiptimin e saktë.
- ✓ Mund të flitet me një ton zëri normal, nuk ka nevojë të bërtitet. Shpejtësia e të folurit duhet adaptuar: as shumë shpejt as shumë ngadalë.
 - ✓ Mundësisht të përdoren fraza të shkurtra, të thjeshta por të plota. Nuk duhet folur si me fëmijët. Duhet vënë theksi mbi fjalën e parë të frazës. Duhet përdorur shprehje të fytyrës në lidhje me temën e bisedës.
 - ✓ Jo të gjithë tingujt janë të dukshëm në buzë: duhet bërë e mundur që personi që nuk dëgjon të mund të shohë gjithçka është e dukshme në buzë.
 - ✓ Kur përdoren emra njerëzish, zonash apo terma jo të zakonshëm leximi i buzëve është shumë i vështirë. Nëse ai që nuk dëgjon, edhe pse sforcohet nuk arrin të kuptojë mesazhin, mund të shkruhet fjala në një letër, ose mund të përdoret alfabeti i shenjave, nëse dihet.
 - ✓ Edhe pse personi që nuk dëgjon mban protezë akustike, jo gjithmonë arrin të perceptojë në mënyrë perfekte atë çka flitet. Për këtë duhet të sillemi sipas këtyre rregullave komunikimi (Nano L., et al., f.47-48).

• Shqiptimi i qartë

Përveç gjuhës së shenjave, studentët me aftësi të kufizuara dëgjimore mbështeten kryesisht në sinkronizimin e buzëve për të kuptuar fjalën ose frazën e përmendur nga një person. Nëse shqiptimi nuk është i duhur, do të ngatërrojë studentin duke penguar komunikimin e tyre me pedagogun.

• Minimizoni zhurmat në sfond

Këshillohet gjithmonë që të reduktohet çdo burim i zhurmës

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

së sfondit në klasë, veçanërisht nëse studentët përdorin ndonjë aparat dëgjimi. Aparatet e dëgjimit nuk filtojnë asnjë tingull të veçantë. Përkundrazi, ato thjesht përforcojnë çdo zhurmë të disponueshme në vend. Pra, përdorimi i aparatit të dëgjimit së bashku me zhurmën e madhe të sfondit nuk do t'vi ndihmojë studentët me dëmtim të dëgjimit (Panigrahi S., 2021). Studentët që kanë dëmtim dëgjimi e kanë shumë të vështirë të përqendrohen kur ka zhurmë në sfond. Bllokimi i një pjese ose të gjithë kësaj zhurme përmes mbylljes së dyerve ose dritareve mund të jetë një masë e thjeshtë dhe efektive. Mos harroni se edhe nëse studenti/tët tuaj përdorin teknologjinë e dëgjimit ndihmës, ata nuk dëgjojnë në të njëjtën mënyrë si bashkëmoshatarët e tyre. Ata do të përfitojnë nga minimizimi i zhurmave të panevojshme të sfondit (Media Access Australia, 2012).

- **Përfshini mjete ndihmëse pamore në mësimdhënie**

Mjetet pamore janë të dobishme për çdo student, madje edhe për studentët pa ndonjë vështirësi në dëgjim. Shkrimi i frazave ose përdorimi i figurave, videove dhe slajdeve jo vetëm që do t'vi ndihmojë ata që nuk dëgjojnë në masën maksimale, por edhe do ta bëjnë orën interesante për ta (Panigrahi S., 2021).

- **Siguroni fletëpalosje me shkrim dhe mjete ndihmëse vizuale**

Studentët e shurdhër që lexojnë buzët, duke parë interpretin ose duke përdorur një aparat dëgjimi mund ta kenë të vështirë të marrin shënime nga një tabelë e bardhë në të njëjtën kohë. Kështu që, në mënyrë që studenti juaj i shurdhër të mos humbasë asgjë të rëndësishme, vendosini të gjitha informacionet dhe njoftimet nga klasa në dispozicion në formën e një fletushke me shkrim. Mjetet ndihmëse vizuale dhe materialet mësimore janë një mënyrë e

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

shkëlqyer për të mbështetur studentët që nuk dëgjojnë, por është e rëndësishme të mos nxitoni në përmbajtjen vizuale, veçanërisht kur jeni duke folur në të njëjtën kohë. Jepuni kohë për të parë përmbajtjen vizuale dhe për ta marrë atë përpara se të filloni të flisni. Ata kanë nevojë për kohë për të kaluar midis shikimit dhe dëgjimit (Deaf Unity, 2020).

- **Përdorni burimet në dispozicion**

Ju mund ta merrni në konsideratë të mësoni gjuhën e shenjave dhe të inkurajoni anëtarët e tjerë të klasës që të mësojnë gjithashtu gjuhën e shenjave. Për më tepër, ju mund të përdorni teknologjinë e disponueshme për të ndihmuar studentët që nuk dëgjojnë. Për shembull, nëse është e mundur, lejoni studentët që nuk dëgjojnë ta regjistrojnë mësimin me titra të drejtpërdrejta në distancë ose siguroni vetë një regjistrim të mësimin, në mënyrë që një transkript të mund të vihet në dispozicion më vonë.

- **Shfaqni videon e titruar ose të interpretuar**

Nëse po përdorni videon si pjesë të mësimin në klasë, përpikuni të gjeni opsione të interpretuara në gjuhën e shenjave ose të titrave. Nëse këto nuk janë të disponueshme, merrni parasysh se si ta angazhoni studentin tuaj të shurdhër me materialin mësimor në video. Gjëja më e rëndësishme për mësuesit është që të jenë sa më gjithëpërfshirës të jetë e mundur në çdo hap përgjatë rrugëtimit të studentëve që nuk dëgjojnë (Deaf Unity, 2020). Të gjithë studentët përfitojnë nga titrat dhe veçanërisht ata që janë të shurdhër ose me dëgjim të dëmtuar, plus ata që kanë anglishten si gjuhë të dytë. (Media Access Australia, 2012).

- **Kontakti me studentët tuaj të shurdhër**

Sigurohuni që studentët tuaj të shurdhër të dinë se ju jeni aty për ta dhe përshtatni strategjitë tuaja të mësimdhënies sipas çdo

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

gjëje me të cilën ata ndihen rehat. Respektimi i zgjedhjeve të tyre është i rëndësishëm. Ju dëshironi t'i ndihmoni t'i fuqizoni ata që të jenë studentët më të mirë që mund të jenë. Përpara, gjatë dhe pas një mësimi kontrolloni nëse ata e kanë kuptuar atë që po mësoni dhe përsëritni çdo gjë që ju kërkojnë të përsërisni për ta.

• Aksesin në vlerësime dhe provime

Për studentët që nuk dëgjojnë, vështirësitë e tyre gjuhësore dhe qasja në format e shkruara të vlerësimit mund të jenë pengesë për aftësinë e tyre për të performuar në kushte standarde të provimit.

Ekzistojnë një sërë rregullimesh lidhur me aksesin për studentët që nuk dëgjojnë, duke përfshirë:

- Kohë shtesë për vlerësime/provime;
- Dokumente gjuhësore të modifikuara - struktura e gjuhës dhe e fjalisë mund të ndryshohet në mënyrë që studentët e shurdhër ta kenë më të lehtë t'u përgjigjen pyetjeve;
- Një lexues - transkripti lexohet për studentët e shurdhër, të cilët përballen me vështirësi në përpunimin e informacionit të shkruar
- Modifikim i gjuhës verbale - një person sqaron formulimin e pyetjes gjatë provimeve (Education Wales, f.15).

3. PËR MËSIMDHËNIEN E STUDENTËVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR FIZIKE

Një dëmtim fizik përkufizohet si çdo lloj aftësie e kufizuar, e cila në mënyrë thelbësore, kufizon funksionimin fizik të gjymtyrëve apo aftësitë e holla apo të trasha lëvizore. Këto kufizime mund të ndikojnë forcën, shpejtësinë, kohëzgjatjen, koordinimin, shkathhtësinë e dorës dhe lëvizshmërinë e përgjithshme. Paraliza cerebrale, skleroza e shumëfishtë, distrofia muskulare, paraliza e plotë apo e pjesshme, goditja në tru, poliomeliti, artriti, amputimi (gjymtimi) dhe sindroma tunel e kyçit të dorës (carpal tunnel syndrome) janë shembuj të dëmtimeve (Florida Atlantic University, 2014).

STRATEGJI EFEKTIVE TË MENAXHIMIT TË KLASËS DHE MËSIMDHËNIES

Ekzistojnë një sërë strategjish mësimore gjithëpërfshirëse që mund t'i ndihmojnë të gjithë këta studentë të mësojnë, por ka disa strategji specifike që janë të dobishme në mësimdhënien e një grupi që përfshin studentët me dëmtime fizike (Australian Government, Department of Education, 2021).

- **Përshtatni mjedisin e klasës për të mbështetur procesin e të nxënit**

Heqja e barrierave fizike duke përfshirë teknologjinë dhe përshtatja e mjedisit të klasës për të mbështetur pjesëmarrjen dhe ngritja e vetëvlerësimit dhe e pavarësisë së studentit. Studentët që përdorin karrige me rrota, kapëse ose paterica, ose që lodhen lehtë, mund ta kenë të vështirë të lëvizin brenda kufizimeve të orarit të

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

mësimeve. Mungesa ose vonesa mund të jetë rezultat i distancës midis vendeve të mësimi, kështu që në fund të mësimi mund t'ju duhet të përmbliidhni çdo informacion të dhënë në fillim.

- **Ofroni mundësi për studentët që ata të shprehin atë çfarë dinë**

Jepuni studentëve mundësinë që të zgjedhin se si duan të prezantojnë dhe të shprehin njohuritë e tyre për një temë të caktuar, p.sh., përmes përdorimit të videove apo grafikëve, nëse përballen me vështirësi në komunikim oral apo në komunikimin me shkrim.

- **Nxitni interesin dhe motivimin për të mësuar**

Përshtatni mësimin dhe përfshini opsione alternative për studentët, me qëllim që ata të demonstrojnë atë çfarë dinë dhe çfarë mund të bëjnë. P.sh., mund të reduktoni sasinë e shkrimit për ata që lodhen shpejt për shkak të dhimbjes dhe mund të reduktoni mundimin e kërkuar në rastin e kopjimit nga dërrasa e zezë.

- **Përdorni teknologjinë**

Jepuni studentëve akses në teknologji, si: laptop, kompjuter, etj. për të zhvilluar idetë dhe për të paraqitur detyrat e tyre. Në mënyrë alternative, teknologjia, si: stilolapsa të dizenuara në mënyrë ergonomike, dërrasa e pjerrët, së bashku me pajisjet e klasës të përshtatura në lartësinë e duhur mund të funksionojnë për ata persona, të cilët e kanë sfidë shkrimin e dorës (Ministry of Education, 2015, f. 16).

- **Krijoni mundësi alternative mësimi**

Kontrolloni nëse aktivitetet akademike që zhvillohen jashtë

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

universitetit (si vizitat, intervistat ose puna në terren) janë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje. Konsideroni praktikat shtesë laboratorike, filmat ose videot si opsione alternative për udhëtimet në terren.

STRATEGJITË E VLERËSIMIT

Në shqyrtimin e formave alternative të vlerësimit, objektivi është mundësitë e barabarta, jo një rezultat i garantuar. Nga ju nuk pritet të ulni standardet për të akomoduar studentët me aftësi të kufizuara, por përkundrazi ju kërkohet t'ju jepni atyre një mundësi të arsyeshme për të demonstruar atë që kanë mësuar.

Studentët me aftësi të kufizuara lëvizore mund të kenë nevojë për rregullime të veçanta në detyrat e vlerësimit. Pasi të keni një pamje të qartë se si ndikon aftësia e kufizuar në performancë, mund të merrni parasysh strategjitë alternative të vlerësimit, si ato të sugjeruara më poshtë:

- ✓ Një lexues ose një provim me gojë (qoftë duke paraqitur përgjigjet në kasetë ose duke marrë pjesë në provim me gojë) janë alternativa ndaj letrës së shkruar tradicionale. Provimi me zë nuk është një opsion i lehtë për studentët. Jepni të njëjtën kohë për provimin me zë si për provimin me shkrim, por lejoni kohë shtesë që ai të dëgjojë, të përmirësojë ose të modifikojë përgjigjet. Në vlerësimin tuaj, duhet të merret parasysh fakti që përgjigjet e folura ka të ngjarë të jenë më pak koherente sesa përgjigjet me shkrim.
- ✓ Për disa studentë kombinimi i provimit me shkrim dhe me zë do të jetë më i përshtatshmi. Lëri studentët të shkruajnë plan-përgjigjet ose të bëjnë shënime skicë, por më pas t'i përgjigjen pyetjes me zë. Vlerësimi juaj duhet të bazohet në

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

- shënimet dhe në prezantimin e folur.
- ✓ Studentët mund të kenë nevojë të përdorin një kompjuter personal ose një asistent personal në provim. Nëse po, mund të jetë e nevojshme të sigurohet hapësirë shtesë për pajisjet, ose një vend i veçantë provimi nëse zhurma nga pajisjet (p.sh. një sintetizues zëri) ka të ngjarë të shpërqendrojë studentët e tjerë.
 - ✓ Siguroni kohë shtesë në provime për studentët që e kanë të reduktuar shpejtësinë e shkrimit. Disa studentë me aftësi të kufizuara lëvizore mund të kenë nevojë për ndërprerje për pushim. Provimet në shtëpi mund të jenë opsione, duke qenë se disa prej mund të kenë nevojë për kohë më shumë për të përfunduar provimet.
 - ✓ Lejo zgjatje të afateve të dorëzimit të detyrave nëse kërkohet një kërkim i gjerë që përfshin aktivitet fizik (p.sh. vizitae të shpeshta në bibliotekë ose mbledhje të dhënash nga vende të ndryshme) (Australian Government, Department of Education, 2021).

4. PËR MËSIMDHËNIEN E STUDENTËVE ME ÇRREGULLIME TË ADHD

Çrregullimi i mungesës së vëmendjes/hiperaktiviteti

Çrregullimi i mungesës së vëmendjes, hiperaktivitetit (i njohur gjithashtu si ADHD) karakterizohet nga simptoma të cilat përfshijnë mungesën e vëmendjes, hiperaktivitetin dhe sjelljen impulsive.

Tipari thelbësor i çrregullimit të mungesës së vëmendjes/hiperaktivitetit (ADHD) është një model i vazhdueshëm i mungesës së vëmendjes dhe/ose hiperaktivitetit-impulsivitetit që ndërhyt në funksionimin ose zhvillimin ((DSM-5-TR, 2022, f.70).

STRATEGJI EFEKTIVE TË MENAXHIMIT TË KLASËS DHE MËSIMDHËNIES

• Tërhiqni vëmendjen e tyre përpara se të flisni

Kontakti me sy, gjestet, prekja ose nxitjet verbale mund të përdoren për të tërhequr vëmendjen e plotë të fëmijëve përpara se t'u jepni udhëzime ose t'u flisni atyre.

•Flisni qartë

Jepni udhëzime të qarta dhe të drejtpërdrejta për detyrën, sjelljen e pritur dhe sa kohë kanë fëmijët. Këto udhëzime mund të kenë nevojë të përsëriten në fillim të çdo detyre të re.

- **Vendosni rregulla të qarta dhe rutinë në klasë**

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

Studentët me ADHD do të mësojnë më mirë kur pritshmëritë e qarta në klasë komunikohen plotësisht (Henderson, 2008). Për një menaxhim më të mirë të sjelljeve, mësimi i rregullave dhe pritshmërive në klasë është i domosdoshëm.

- **Përdorni mjete ndihmëse vizuale**

Merrni në konsideratë përdorimin e fotografive, videove, prezantimeve në PoerPoint, objekteve ose demonstrimeve për të shpjeguar konceptet dhe detyrat. Mësimet praktike mund të jenë shumë tërheqëse. Studentët me ADHD janë persona ndijor dhe priren t'i përgjigjen mirë shenjave vizuale. Kur jepni informacion, merrni parasysh mënyrat se si mund të përfshini fotografi, ngjyra, video dhe tabela në klasën tuaj për t'i ndihmuar studentët me ADHD të përthithin më lehtë informacionin e ri. Shfaqja e pikave kyçe në tabelë mund të ndihmojë për t'u kujtuar studentëve se ku duhet të përqendrohen.

- **Minimizoni shpërqendrimet**

Minimizimi i shpërqendrimave dhe ndërprerjeve është thelbësor për të ndihmuar studentët me ADHD të qëndrojnë të fokusuar në klasë. Ulja e studentëve përpara klasës dhe larg dymve mund të largojë shpërqendrimet e mundshme nga lëvizja brenda dhe jashtë klasës.

- **Thjeshtoni detyrat dhe udhëzimet**

Studentët me ADHD kanë më shumë gjasa të heqin dorë dhe të zhgënjehen kur u jepet një detyrë akademike që tejkalon nivelin e tyre mësimor. Ata, gjithashtu, priren të mërzhiten dhe të jenë të pavëmendshëm me detyra të thjeshta. Përshtatja e vështirësisë së detyrës (p.sh. përputhja e vështirësisë me nivelin e aftësive të

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

studentit) është një mënyrë për të angazhuar studentët me ADHD dhe për t'i ndihmuar ata të shmangin zhgënjimin. Disa studentë me ADHD mund të përfitojnë gjithashtu nga fillimi me detyra më të lehta dhe ngadalë duke përparuar në detyra më të vështira ndërsa rritet besimi i tyre. Ndarja e detyrave në hapa më të vegjël u jep studentëve një sërë qëllimesh për të punuar, të cilat mund të ndihmojnë që puna të ndihet më e arritshme. Kur studentët me ADHD ndihen të realizuar, ata kanë më shumë gjasa të tregojnë interes për të mësuarit e tyre.

- **Kohëzgjatja e detyrës.**

Duke pasur parasysh hapësirën e shkurtër të vëmendjes së studentëve me ADHD, detyrat akademike duhet të jenë të shkurtra, me reagime të menjëhershme në lidhje me saktësinë. Për shembull, projektet e gjata mund të ndahen në pjesë më të vogla. Mund të jetë gjithashtu e dobishme t'i lejonit studentët të bëjnë pushime gjatë periudhave të gjata të punës në klasë.

- **Lejoni pushime dhe lëvizje**

Qëndrimi ulur është një sfidë për studentët me ADHD dhe mund të veprojë si një pengesë për të mësuarit e tyre. Gjeneroni kohë për pushime të rregullta për të gjithë klasën për t'u shtrirë dhe lëvizur midis aktiviteteve të klasës për t'u dhënë studentëve me ADHD mundësinë për të rregulluar dhe rifokusuar. Kini parasysh se disa studentë mund ta kenë të vështirë të ripërqendrohen pas një pushimi, kështu që eksploronit se çfarë funksionon për studentët tuaj. Aty ku është e mundur, përpiquni të përfshini lëvizjen në aktivitetet mësimore për t'i mbajtur studentët të angazhuar. Nëse vëreni se një student fillon të shqetësohet, provoni t'i caktoni një detyrë të vogël që kërkon lëvizje nëpër klasë. Kjo mund të jetë

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

shpërndarja e fletëve të punës, ngritja për të lënë mënjane burimet ose ndihma për të shkruar në tabelë.

- **Jepini komente pozitive**

Personat me ADHD mund t'i përgjigjen më mirë marrjes së përforcimeve të rregullta pozitive sesa të qortohen vazhdimisht. Njohja e arritjeve të tyre, qoftë edhe ato të voglat, mund t'ju ndihmojë t'i mbani të motivuar. Është e rëndësishme të sigurohet që lavdërimi të jepet edhe para bashkëmoshatarëve të tyre. Mundohuni të mos korrigjoni ose qortoni shumë shpejt. Filloni duke njohur atë që ata kanë bërë mirë, më pas ofroni sugjerime për përmirësim dhe përfundoni duke përforcuar atë që po bëjnë mirë. Përdorni gabimet e tyre si një mundësi për t'i ndihmuar ata të mësojnë duke u bërë pyetje të tilla si: “A tingëllon kjo si përgjigjja e duhur?” ose “A është kjo një mënyrë e mirë apo e keqe për të folur në klasë?”

STRUKTURIMI I MËSIMEVE

- **Fillimi i mësimit**

- ✓ Tërhiqni vëmendjen e studentëve me një sinjal vizual dhe/ose dëgjimor për të treguar se mësimi po fillon dhe pritet që ata të dëgjojnë.
- ✓ Rendisni planin e mësimit në tabelë me hapa të thjeshtë që studentët t'i referohen gjatë gjithë mësimit.
- ✓ Tregojuni qartë studentëve se çfarë do të mësojnë dhe çfarë do t'u nevojitet për të marrë pjesë në mësimit.

- **Gjatë orës së mësimit**

Alternoni midis aktiviteteve që kapin nivele të ndryshme

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

interesi për të ndihmuar studentët me ADHD të qëndrojnë të fokusuar dhe të angazhuar në klasë. Merrni parasysh kryerjen e detyrave me përqendrim të lartë më herët gjatë mësimit ose në një kohë që ju e keni identifikuar si kohën më të mirë të tyre të ‘vigjilencës’. Kjo është kur ata kanë më shumë gjasa të ruajnë fokusin dhe të ruajnë informacionin. Studentët me ADHD mund ta kenë të vështirë të kalojnë nga një detyrë në tjetrën. Ju mund t’i ndihmoni ata të kalojnë duke i bërë të ditur klasës disa minuta përpara se të filloni një aktivitet të ri.

- **Në përfundim të mësimit**

Tërhiqni vëmendjen e studentëve dhe përmbliidhni atë që është trajtuar gjatë mësimit. Nëse ka detyra shtëpie, shkruajini ato në tabelë dhe bëni klasën të përsërisë detyrën dhe/ose ta dokumentojë atë përpara se të largohet nga klasa për ditën.

5. PËR MËSIMDHËNIEN E STUDENTËVE ME ÇRREGULLIME TË SPEKTRIT AUTIK

Personat autikë, zakonisht, nuk shfaqin nevojë për afeksion ose nevojë për kontakt me asnjëri, madje as me prindërit e tyre. Shumë studime, megjithatë, kanë treguar se personat autikë shprehin emocione dhe nuk mund të konsiderohen sikur kanë mungesë të dukshme të reagimeve emocionale, siç është vënë në dukje në përshkrimet tradicionale të këtij çrregullimi.

Po listojmë më poshtë disa karakteristika të personave me autizëm:

- ✓ Mungesa apo përdorimi shumë i kufizuar i të folurit është karakteristikë e personave autikë. Nëse e folura është e pranishme, ajo, pothuajse kurrë, nuk përdoret për komunikim, veçse në një mënyrë rudimentare, si p.sh., duke thënë “Po” në përgjigje të një pyetjeje, apo përmes përdorimit të ekolalisë, që është përsëritja si papagall e pak fjalëve.
- ✓ E folura e personave autikë mungon prosodia, e cila ka të bëjë me ndryshimet në ritmin dhe në intonacionin, e cila i jep melodi të folurit normal. Fëmija me autizëm flet në mënyrë monotone, pa përdorur theksin tek fjalët apo pa përdorur uljet e ngritjet e zërit, të cilat ndihmojnë në përshtatjen e emocionit me kuptimin.
- ✓ Vetëstimulimi.haset dendur tek fëmijët autikë dhe zakonisht ka formën e lëvizjeve të tilla të përsëritura, si: përplasje e kokës, rrotullimi, lëkundje, të cilat mund të vazhdojnë deri në një orë. Lëvizje të tjera të çuditshme dhe të përsëritura janë jotipike.
- ✓ Disa individë me autizëm kanë inteligjencë normale dhe

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

disa individë kanë talente të veçanta në zona të tilla si muzika apo kujtesa. Individët me autizëm, megjithatë, mund të kenë probleme të tjera mendore apo emocionale të cilat bashkekzistojnë me autizmin e tyre. Disa prej këtyre çrregullimeve të tjera mund të përfshijnë çrregullime në kontrollin e impulseve, çrregullime të gjendjes shpirtërore, çrregullime të ankthit dhe aftësi të kufizuar intelektuale.

- ✓ Probleme me përdorimin dhe të kuptuarit e gjuhës ose aspekteve të caktuara të gjuhës, si: sarkazma, shprehjet dhe gjuha e trupit.
- ✓ Një nevojë për një rutinë të veçantë në mënyrë që ata të dinë se çfarë të presin pasi mund të zhgënjehen kur gjërat nuk shkojnë ashtu siç kishin pritur.
- ✓ Vështirësi për të kuptuar mendimin e një personi tjetër ose për të kuptuar ndjenjat e një personi tjetër.
- ✓ Vështirësi për të punuar ose për të marrë pjesë në aktivitete pa fund të qartë (p.sh., një aktivitet me shkrim të hapur, një leksion në klasë)
- ✓ Vështirësi në kalimin nga një aktivitet në tjetrin, veçanërisht nëse duhet të kalojnë nga diçka e këndshme në diçka jo të këndshme
- ✓ Vështirësi në organizimin e tyre në lojë produktive kur nuk drejtohen ose nuk u jepen udhëzime specifike.

STRATEGJI EFEKTIVE TË MENAXHIMIT TË KLASËS DHE MËSIMDHËNIES

- Jini të qetë dhe pozitiv.
- Krijoni kohë për punë në çifte dhe në grupe të vogla.
- Përdorni lavdërime përshkruese për të përforcuar zhvillimin e

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

- sjelljeve pozitive (Eley, 2020).
- Njerëzit me autizëm kanë probleme me të menduarit abstrakt dhe konceptual. Disa mund të fitojnë përfundimisht aftësi abstrakte, por të tjerët nuk do të fitojnë kurrë. Kur duhen përdorur koncepte abstrakte, përdorni shenja vizuale, të tilla si vizatime ose fjalë të shkruara, për të formësuar idenë abstrakte. Jini sa më konkretë në të gjitha ndërveprimet tuaja me këta studentë. Shmangni pyetjet e paqarta të tilla si: “Pse e bëre këtë?” Në vend të kësaj, thuaj, “Nuk më pëlqeu kur e përplase librin. Herën tjetër vendose librin me butësi dhe më thuaj se je i zemëruar. Jini sa më konkretë në të gjitha ndërveprimet tuaja me këta studentë.
 - Një rritje e sjelljeve të pazakonta ose të vështira ndoshta tregon një rritje të stresit. Ndonjëherë stresi shkaktohet nga ndjenja e humbjes së kontrollit. Shumë herë stresi do të lehtësohet vetëm kur studenti largohet fizikisht nga ngjarja ose situata stresuese. Kur kjo ndodh, një “vend i sigurt” ose “person i sigurt” mund të jetë i dobishëm.
 - Mos e merrni sjelljen e keqe personalisht. Personi me funksion të lartë me autizëm nuk është një person manipulues, planifikues që përpiqet të vështirësojë jetën. Ata rrallë, për të mos thënë ndonjëherë, janë të aftë të jenë manipulues. Zakonisht sjellja e keqe është rezultat i përpjekjeve për t’i mbijetuar përvojave, të cilat mund të jenë konfuze, çorientuese ose të frikshme.
 - Shumica e njerëzve me autizëm me funksion të lartë e përdorin dhe e interpretojnë fjalën fjalë për fjalë. Derisa të njihni aftësitë e individit, duhet të shmangni:
 - ✓ idiomat (p.sh., mbaj frymën);
 - ✓ kuptime të dyfishta (shumica e shakave kanë kuptime të

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

- dyfishta);
- ✓ sarkazëm (p.sh., duke thënë: “Shkëlqyeshëm!” pasi ai sapo ka gabuar);
 - ✓ pseudonimet; dhe
 - ✓ emra përkëdhelës
 - Mos harroni se shprehjet e fytyrës dhe shenjat e tjera sociale mund të mos funksionojnë. Shumica e individëve me autizëm kanë vështirësi të lexojnë shprehjet e fytyrës dhe të interpretojnë “gjuhën e trupit”.
 - Nëse studenti duket se nuk po bën një detyrë, ndajeni atë në hapa më të vegjël ose prezantoje detyrën në disa mënyra (p.sh., vizualisht, verbalisht, fizikisht).
 - Shmangni mbingarkesat verbale! Jini të qartë! Përdorni fjali më të shkurtra nëse kupton se studenti nuk po ju kupton plotësisht. Edhe pse ai ndoshta nuk ka asnjë problem dëgjimi dhe mund të jetë duke ju kushtuar vëmendje, ai mund të ketë vështirësi të kuptojë çështjen tuaj kryesore dhe të identifikojë informacione të rëndësishme.
 - Përgatitni studentin për të gjitha ndryshimet mjedisore dhe/ose në rutinë. Përdorni një orar të shkruar ose vizual për ta përgatitur atë për ndryshim.
 - Kini parasysh se nivelet normale të të dhënave dëgjimore dhe vizuale mund të perceptohen nga studenti si shumë ose shumë pak. Për shembull, zhurma e dritës fluoreshente është jashtëzakonisht shpërqendruese për disa njerëz me autizëm. Merrni parasysh ndryshimet mjedisore si heqja e “rrëmujës vizuale” nga dhoma ose ndryshimet e ndenjësive nëse studenti duket i hutuar ose i mërzitur nga mjedisi i klasës së tij.
 - Nëse studenti juaj me funksion të lartë me autizëm përdor argumente verbale të përsëritura dhe/ose pyetje të përsëritura, ju duhet të ndërprisni atë.

6. PËR MËSIMDHËNIEN E STUDENTËVE ME ÇRREGULLIM SPECIFIK NË TË NXËNË

Aftësitë e kufizuara specifike të të nxënit (ose çrregullimet e të mësuarit) (SLD) janë një term i përgjithshëm për një sërë kufizimesh që prekin individët në proceset e leximit dhe shkrimit dhe në detyrat e lidhura me matematikën (Coelho D.T., 2014, f.211).

Simptomat janë:

- ✓ Lexim i pasaktë i fjalëve apo lexim i ngadaltë dhe i mundimshëm (p.sh., lexon fjalë të thjeshta me zë të lartë në mënyrë të pasaktë ose lexon ngadalë dhe me hezitim, dendur i hamendëson fjalët, ka vështirësi në të shprehurit me zë të lartë të fjalëve).
- ✓ Vështirësi në të kuptuarit e kuptimit të asaj çfarë lexon (p.sh., mund të lexojë tekstin me kujdes, por nuk e kupton sekuencën, marrëdhëniet, deduktimet apo kuptime më të thella të asaj që lexon).
- ✓ Vështirësi me shqiptimin (p.sh., mund të shtojë, të heqë apo të zëvendësojë zanoret apo bashkëtingëlloret).
- ✓ Vështirësi me gjuhën e shkruar (p.sh., bën gabime të shumta gramatikore apo gabime të pikëzimit në fjali, përdor organizim të varfër të paragrafit, gjuhës apo ideve të shkruara u mungon qartësia).
- ✓ Vështirësi që kanë lidhje me kuptimin për numrat, me fakte për numrat apo që kanë lidhje me llogaritjen (p.sh., kanë të kuptuar të varfër të numrave, të madhësisë dhe të marrëdhënieve mes numrave; numëron me gishta për të mbledhur numrat e thjeshtë në vend që të kujtojë faktet matematikore ashtu si veprojnë bashkëmoshatarët; mbetet në mes të llogaritjes matematikore dhe mund të ndryshojë procedurat).

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

- ✓ Vështirësi me arsyetimin matematikor (p.sh., ka vështirësi të thella në zbatimin e koncepteve, fakteve apo të procedurave matematikore për zgjidhjen e problemeve sasiore).

STRATEGJI EFEKTIVE TË MENAXHIMIT TË KLASËS DHE MËSIMDHËNIES

Mund të kenë nevojë për mbështetje në të folur, komunikim dhe aftësitë sociale.

- Mund të kenë nevojë për mbështetje emocionale-sjellore dhe psiko-sociale.
- Mund të kenë nevojë për mbështetje për të kuptuar, për të folur, lexuar, të shkruar, shqiptuar ose për të bërë llogaritjet matematikore.
- Mund të kenë nevojë për ndihmë për të kuptuar informacione/udhëzime verbale dhe me shkrim. (University Grants, 2022, f.18).

7. PËR MËSIMDHËNIEN E STUDENTËVE ME ÇRREGULLIME TË KOMUNIKIMIT

Çrregullimet e komunikimit përfshijnë mangësi në gjuhë, në të folur dhe në komunikim (DSM-5-TR, 2022, f.47). Çrregullimet e komunikimit përfshijnë: çrregullimin e gjuhës, çrregullimin e gjuhës së folur, çrregullimin e komunikimit social (pragmatik) dhe çrregullimin e rrjedhshmërisë me fillim në fëmijëri (belbëzimin). Veçoritë thelbësore diagnostikuese të çrregullimit të gjuhës janë vështirësi në përvetësimin dhe në përdorimin e gjuhës për shkak të mangësive në të kuptuar apo në prodhimin e fjalorit, në gramatikë, në strukturën e fjalisë dhe në bisedë. Mangësitë e gjuhës janë të dukshme në komunikimin e folur, në komunikimin e shkruar apo në gjuhën e shenjave. **Çrregullimi i gjuhës së folur është një çrregullim i artikulimit në të cilin personat nuk arrijnë të përdorin tingujt e të folurit që janë normalë për nivelin e tyre të zhvillimit.** Veçoria thelbësore e çrregullimit të rrjedhshmërisë me fillim në fëmijëri (belbëzimi) është një çrregullim në rrjedhshmërinë normale dhe në modelin kohor të të folurit që është i papërshtatshëm për moshën e individit. Ky çrregullim karakterizohet nga përsëritje të dendura apo zgjatje të tingujve ose të rrokjeve dhe nga tipa të tjerë të mosrrjedhshmërive në të folur, duke përfshirë prishje të fjalëve (p.sh., pauza brenda një fjale), bllokim i dëgjueshëm apo i heshtur (pauza të mbushura apo të paplotësuara në të folur), perifrazime (zëvendësime fjalësh për të shmangur fjalët problematike), fjalë të thëna me tension fizik shumë të madh dhe përsëritje të të gjithë fjalës monosilabike. Çrregullimi i komunikimit social (pragmatik) karakterizohet nga vështirësi kryesore me pragmatikën apo me përdorimin social të gjuhës dhe komunikimit, i shfaqur në mangësi në të kuptuarit

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

dhe në pasimin e rregullave sociale të komunikimit verbal dhe joverbal në kontekste të natyrshme, mangësi në ndryshimin e gjuhës në përshtatje me nevojat e dëgjuesit apo me situatën dhe mangësi në ndjekjen e rregullave për biseda dhe tregime historish. Mangësitë në komunikim social shkaktojnë kufizime domethënëse në komunikimin efikas, në pjesëmarrjen sociale në zhvillimin e marrëdhënieve sociale, në arritjet akademike apo në performancën profesionale.

STRATEGJI EFEKTIVE TË MENAXHIMIT TË KLASËS DHE MËSIMDHËNIES

- Mund të kenë nevojë për mbështetje në të folur dhe në komunikim.
- Mund të kenë nevojë për mbështetje emocionale-sjellore dhe psiko-sociale.
- Mund të kërkonë ndihmë në përdorimin e infrastrukturës ose TIK-ut.
- Mund të kërkojnë terapi të shpeshta të të folurit ose ndërhyrje të tjera mjekësore.
- Mund të kenë nevojë për t'u ulur në vende preferenciale për të marrë pjesë në aktivitete (University Grants, 2022, f.17).

1.

8. PËR MËSIMDHËNIEN E STUDENTËVE ME PROBLEME TË SHËNDEMIT MENDOR

Shëndeti mendor përbën një pjesë integrale dhe thelbësore të shëndetit. OBSH pohon: “Shëndeti është një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe shoqërore dhe jo vetëm mungesë e sëmundjes apo dobësisë. Shëndeti mendor është një gjendje e mirëqenies në të cilën një individ realizon aftësitë e tij, mund të përshtatet me streset e zakonshme të jetës, mund të punojë me produktivitet dhe është i aftë të japë kontribut në komunitetin e tij”(WHO, 2016).

Termtat “sëmundje mendore”, “probleme të shëndetit mendor” dhe “çrregullim mendor” shpesh përdoren në mënyrë të ndërshkëmbyeshme. Problemet e shëndetit mendor në përgjithësi përshkruhen si probleme që pengojnë apo ndërhyjnë në aftësitë e zakonshme sociale, mendore dhe emocionale të një personi dhe mund të kenë lidhje me sfidat e jetës dhe ndjenjat e pamundësisë për t’i bërë ballë. Një problem i shëndetit mendor ndërhyr në mënyrën se si një person mendon, ndihet dhe sillet, por në një masë më të vogël se sa një sëmundje mendore. Problemet e shëndetit mendor janë më pak të rënda se sëmundja mendore dhe, zakonisht, mund të zgjidhen me burimet e vetë individit. Sidoqoftë, problemet e shëndetit mendor mund të përparojnë drejt sëmundjes mendore nëse nuk zgjidhen (Francis A.P. (2014).

Në nivelin më të thjeshtë, sëmundjet mendore mund të përkufizohen si çrregullime të rënda të sjelljes, të gjendjes shpirtërore, të proceseve të menduarit dhe/ose të marrëdhënieve shoqërore dhe ndërnjerëzore. Në diagnozën psikiatrike

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

këto përvoja grupohen nën një sërë titujsh të zakonshëm që mundësojnë përdorimin e përgjigjeve dhe trajtimeve të ngjashme për t'ua ofruar njerëzve me të njëjtat diagnoza. Grupimet më të zakonshme janë çrregullimet e ankthit, çrregullimet afektive, çrregullimet psikotike, përfshirë skizofreninë dhe çrregullimet e personalitetit (Bracken and Thomas 2001) (cituar nga Ryan T., Pritchard J. (2004), f.21).

Sëmundja mendore përcaktohet si një çrregullim i diagnostikueshëm që ka një seri simptomash, të cilat mund të përfshijnë mendime, emocione, sjellje dhe marrëdhënie jo normale (WHO 2011a). Të jetuarit me një sëmundje mendore mund të interferojë në mënyrë domethënëse në jetën e përditshme të një personi dhe në aftësitë e tij mendore, emocionale dhe sociale (Francis A.P. (2014).

DSM-5-TR (2022) e përkufizon çrregullimin mendor si: Një çrregullim mendor është një sindromë e karakterizuar nga çrregullim domethënës klinik tek konjicioni, tek rregullimi emocional apo tek sjellja e individit, çrregullim i cili pasqyron disfunktion në proceset psikologjike, biologjike apo zhvillimore, procese këto që përbëjnë bazën e funksionimit mendor. Çrregullimet mendore, zakonisht, shoqërohen me distres domethënës apo me aftësi të kufizuara në veprimtarinë sociale, profesionale apo në veprimtari të tjera të rëndësishme (f.14).

**STRATEGJI EFEKTIVE TË MENAXHIMIT TË
KLASËS DHE MËSIMDHËNIES**

- Mund të ketë nevojë për mbështetje në të folur, komunikim dhe aftësitë sociale.
- Mund të kenë nevojë për mbështetje emocionale-sjellore dhe psiko-sociale.
- Mund të kenë rrethana shoqëruese intelektuale ose sjellore.
- Mund të kenë nevojë për asistencë në aktivitetet akademike për shkak të vështirësive të lidhura me përqendrimin, kujtesën, shpërqendrimin, impulsivitetin, nervozizmin, frikën, ankthin, etj.
- Mund të kenë nevojë për asistencë në funksionimin kognitiv (arsyetimi, problemzgjdhja, etj.) për shkak të çrregullimeve të të menduarit, humorit, perceptimit, orientimit, kujtesës, që dëmtojnë rëndë gjykimin, sjelljen, aftësinë për të njohur realitetin ose aftësinë për të plotësuar kërkesat e zakonshme të jetës.
- Mund të kërkojnë ndihmë në përdorimin e infrastrukturës ose TIK-ut.
- Mund të jenë të ndjeshëm ndaj dritave të forta, zhurmave të forta, korridoreve të ngarkuara, teksturave, aromave, etj.
- Mund të kërkojnë terapi ose mjekim të shpeshtë (University Grants, 2022, f.19).

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

NË PËRFUNDIM

Ky Udhëzues ka përshkruar shkurtimisht mënyra të ndryshme të menaxhimit të vështirësive të studentëve dhe sugjerime për mbështetjen e tyre në universitet.

Asnjë nga sugjerimet nuk është unik ose i pazakontë - ato janë praktikat e përdorura nga universitete të ndryshme me përvojë në fushën e mbështetjes së këtyre studentëve, për t'i inkurajuar ata.

Urojmë që këto sugjerime të jenë lehtësuese në punën tuaj!

Ju falënderojmë, grupi i punës i projektit IDEA!

BIBLIOGRAFIA

- American Psychiatric Association Washington, DC (2022) “Diagnostic And Statistical Manual Of Mental Disorders, Fifth Edition, Text Revision, Dsm-5-Tr Tm, Usa
- Australian Government, Department of Education (2021). Physical Disability (marrë nga; <https://www.adcet.edu.au/inclusive-teaching/specific-disabilities/physical-disability>).
- CDC (2019). Common Barriers to Participation Experienced by People with Disabilities (marrë nga: <https://www.cdc.gov/ncbddd/disabilityandhealth/disability-barriers.html>).
- Coelho D.T. (2014). Reading, writing and mathematics learning disabilities Specific Learning Disabilities. Special Educational Needs. DOI 10.4399/97888548xxxxx16pag. 211–223.
- Deaf Unity (2020). 7 Teaching Strategies to Empower Deaf Students (marrë nga: 7 Teaching Strategies to Empower Deaf Students | Deaf Unity).
- Education Wales (2019). Support for children and young people with hearing impairment in educational settings (marrë nga: <https://gov.wales/sites/default/files/publications/2019-12/191209-support-for-children-and-young-people-with-hearing-impairment-in-educational-settings.pdf>).
- Francis A.P. (2014). Social Work in Mental Health: Contexts and Theories for Practice. Sage Publications. India.
- Këshilli i Ministrave. Vendim nr.621, dt.22.10.2021. Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj. Tiranë.
- Lupón M., Cardona G., Armayones M. (2021). Public

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

- knowledge of low vision and blindness, and readability of on-topic online information. Elsevier. <https://doi.org/10.1016/j.optom.2020.06.005>.
- Media Access Australia (2017). Five tips for teachers of students with hearing impairment (marrë nga: https://mediaaccess.org.au/latest_news/education/five-tips-for-teachers-of-students-with-hearing-impairment).
 - Ministry of Education (2015). Physical disabilities. A resource for educators (marrë nga: <https://inclusive.tki.org.nz/assets/inclusive-education/MOE-publications/MOESE0042Physicaldisabilities-booklet.pdf>).
 - Nano L., Markja A., Ibërshimi E., Agastra S. (2020). Edukimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara. Për mësuesist ndihmës në arsimin parauniversitar. ASCAP. Tiranë (marrë nga: [Manuali-per-mesuesit-ndihmes.pdf](#) (ascap.edu.al)).
 - Osmanaga F. (2017). Edukimi gjithëpërfshirës: cikël leksionesh. Tiranë, Vllamasi.
 - Panigrahi S. (2021). Teaching Strategies for Hearing Impaired Students (marrë nga: <https://www.thehighereducationreview.com/news/teaching-strategies-for-hearing-impaired-students-nid-1180.html>).
 - Ryan T., Pritchard J. (2004). Good Practice in Adult Mental Health. Jessica Kingsley Publishers. London and Philadelphia.
 - Sahu K.K., Sahu S. (2015). Attitudinal barrier experienced by people with disabilities. Journal of Disabilities Studies, 1(2), 1-2 (marrë nga: https://www.researchgate.net/publication/299657383_Attitudinal_barrier_experienced_by_people_with_disabilities).
 - Strategjia Kombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuar (2005). Tiranë.

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

- University Grants (2022). Accessibility Guidelines and Standards for Higher Education Institutions and Universities. India.
- WHO (2011). World Report on Disability. Malta.
- WHO. 2021. Prevention of blindness and deafness (marrë nga: : https://www.schwerhoerigen-netz.de/fileadmin/user_upload/dsb/Dokumente/Information/Politik_Recht/Hoergeraete/who-grades-hearing.pdf).
- World Vision (2012). E drejta e fëmijëve me aftësi të kufizuara për arsim gjithëpërfshirës - Analizë e historikut të zhvillimit të arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Shqipëri gjatë periudhës 1945 – 2011. Tiranë.

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

WEBOGRAFIA

- <http://learninglinkg.org.au>. Strategies to support ADHD in classroom
- <https://cemh.lbpsb.qc.ca/Portals/cemh/Mood/Teaching-Students-Mental-Health-Disorders.pdf> - Teaching Students with Mental Disorders
- <https://centerontransition.org/resources/publications/download.cfm?id=64>
- https://deafunity.org/article_intervieë/7-teaching-strategies-to-empower-deaf-students/-7 Teaching Strategies to Empower Deaf Students
- https://ibcces.org/blog/2016/07/15/behavior-strategies/?https://ibcces.org/&keyword=&creative=643673812016&gad=1&gclid=CjwKCAjwvfm0BhAëEiëAG2tqzCx2YQndxWVzsueAkatotdsuBhUNxJENq0z4gtyrV-hKbRZqg3PUhoCë0UQAvD_BwE
- <https://resilienteducator.com/classroom-resources/5-tips-for-handling-ebd-kids-emotional-behavior-disorder-in-an-inclusive-classroom/>
- <https://www.iidc.indiana.edu/irca/articles/tips-for-teaching-high-functioning-people-with-autism.html>-Moreno, S. J. & O'Neal, C. (2000). Tips for teaching high functioning people with autism. Croën Point, IN: MAAP Services, Inc.
- <https://www.paho.org/en/topics/mental-health>
- https://www.schwerhoerigen-netz.de/fileadmin/user_upload/dsb/Dokumente/Information/Politik_Recht/Hoergeraete/who-grades-hearing.pdf
- <https://www.understood.org/en/articles/at-a-glance-classroom-accommodations-for-anxiety>

Strategji të mësimdhënies që do të ndihmojnë në mbështetjen e studentëve me aftësi të kufizuara

- https://www2.gov.bc.ca/assets/gov/education/administration/kindergarten-to-grade-12/independent-schools/se_cat_chklst.pdf
- <https://www.weareteachers.com/teaching-blind-students-visually-impaired/> Teaching Students Visually Impaired